



Nr. 60/prol
Dt. 16/08/2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



V E N D I M

Nr. 5 Datë 14. 08. 2018

**“MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGI
ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “GENERAL GREEN ENERGY” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, pika 2, të ligjit nr.6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr.111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika 1/ c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni”, për paisjen me autorizim(miratim ne parim) të subjektit “GENERAL GREEN ENERGY” SH.P.K., me propozim të A.B.U Drin- Bunë dhe oponentës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “GENERAL GREEN ENERGY” SH.P.K me administratore Znj. Blerta ABRIJA, për përdorim të burimit ujor, **Përroi i Peshkopisë** për prodhim energjie elektrike në fshatin Dohoshisht, Njësia Administrative Tomin, Bashkia Dibër, Qarku Dibër .

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti, HEC DOHOSHISHT do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes : X - 44 54 061.915 ; Y - 46 16 942.300 ; Z - + 695.5 m

Koordinatat e godinës së centralit: X - 44 50 959.915 ; Y - 46 13 902.593 ; Z - + 493 m

Koordinatat e pikes së shkarkimit : X - 44 50 959.915 ; Y - 46 13 902.593 ; Z - + 493 m

Prurja mesatare e përroit: Q mes = 1.2 m³/sek;

Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti: Q llog = 1.39 m³/sek;

Prurja ekologjike: Q ekol = 0.165 m³/sek;

Prurja që shkarkohet: Q = 1.39 m³/sek.

2- Autorizimi(miratimi ne parim) i përdorimit të burimit ujor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR

Raimonda GURI



KRYETAR

Ceska MULLJA

